

FITOFOP

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS05

GHS07

GHS08

GHS09

“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

Fitofof është një herbicid sistemik i bazuar në Quizalofop-p-etil i cili klasifikohet në grupin HRAC 1 (A): Frenuesit e acetyl-CoA karboksilazës (frenuesit ACC). Pas aplikimit, barërat e këqija e thithin këtë herbicid përmes gjetheve dhe Fitofof më tej zhvendoset në pikën e rritjes së rrënjës, kërcellit dhe gjetes ku frenon acetyl-CoA karboksilazën dhe parandalon sintezën e acideve yndyrore. Rrënjët e trajtuara skuqen dhe më pas nekrotizohen dhe thahen.

Lënda vepruese: *Quizalofop-P-ethyl...* 50 g/l; 5,46 % (m/m)

Formulimi: *Emulsion i koncentruar (EC)*

Masat parambrojtëse:

- P102: Mbajeni në vende të sigurta, larg fëmijëve.
- Lexoni etiketen para përdorimit.
- Mbajeni larg pijeve dhe ushqimeve për njerëzit dhe kafshët.
- H332: I dëmshëm nëse merret nëpërmjet rrugëve të frymëmarrjes.
- H315: Shkakton irritim të lëkurës.
- H317: Mund të shkaktojë reaksion alergjik të lëkurës.
- H318: Shkakton dëmtim serioz të syve.
- H336: Mund të shkaktojë përgjumje ose marramendje.
- H304: Mund të jetë fatal nëse gjëlltitet ose nëse kalon në rrugët e frymëmarrjes
- H400: Shumë toksik për gjallesat ujore.
- H411: Toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata.
- P261: Shmangni thithjen e pluhurit / tymit / gazeve / mjegullës / avujve / solucionit gjatë frymëmarrjes.
- P264: Lahuni me ujë të bollshëm dhe sapun tërësisht pas trajtimit.
- P270: Mos hani, pini ose pini duhan kur përdorni këtë produkt.
- P280: Vishni doreza mbrojtëse/ veshje mbrojtëse/ pajisje mbrojtëse për fytyrën/ për sytë.
- P362: Hiqni veshjet e ndotura.
- P391: Mblidhni pastroni rrjedhjet.
- P403 + P235: Ruajeni në një vend me ventilim të mirë. Mbajeni në ambient të freskët.
- EUH401: Të evitohen rreziqet e shendetit të njeriut dhe ambientit, në përpuethshmëri me instruksionet për përdorim.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- P301+P310: Në rast gjëlltitje; Telefononi menjëherë Qendrën e helmimeve ose një mjek.
- P331: Mos provokoni të vjella.
- P302 + P352: Në rast kontakti në lëkurë : Lajeni me ujë të bollshëm.
- P304 + P340: Në rast se merret nëpërmjet rrugëve të frymëmarrjes: Largojeni personin në ajër të pastër dhe vendoseni në pozicion që të marrë frymë lirisht.
- P305 + P351 + P338: Në rast kontakti në sy: Shpëlani vazhdimisht për disa minuta me ujë. Hiqni lentet e kontaktit, nëse janë të pranishme dhe nëse është të lehtë për t'u bërë. Vazhdoni shpëlarjen.
- P308 + P313: Nëse je ekspozuar dhe je i shqetësuar: Merrni këshilla / kujdes mjekësor.
- P333 + P313: Në rast irritimi ose skuqje të lëkurës: Merrni këshilla / kujdes mjekësor.

- P501: Shkatërroni ose largoni përmbajtjen/ambalazhin në përputhje me rregullat në fuqi.
- P101: Nëse është e nevojshme tregojeni mjekut ambalazhin ose etiketën e produktit.
- Nuk ka antidot specifik në dispozicion. Trajtoni simptomatikisht.
EUH066 Ekspozimi i përsëritur mund të shkaktojë tharje ose çarje të lëkurës.

Frazat e vecanta S:

SP 1 Mos ndotni ujin me produktin ose ambalazhin e tij (Mos pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujit sipërfaqësor / Shmangni ndotjen e kanaleve kulluese nga kopshtet e fermave dhe rrugëve).

SPo 2 Lani të gjitha veshjet mbrojtëse pas përdorimit.

SPe 3: , respektoni zonën tampon të paspërkatur prej 5 m për të mbrojtur organizmat ujorë.

Ndihma e shpejtë:

Në rast helmimi të vërtetë ose të dyshuar ose reaksioni alergjik, ndërpritni menjëherë përdorimin e produktit dhe pas dhënies së ndihmës së shpejtë, kontaktoni një mjek ose një qendër mjekësore.

Në rast kontakti me lëkurën, lani zonën e prekur me shumë ujë dhe sapun. Në rast kontakti me sytë, lani me shumë ujë, të paktën 15-20 minuta. Në rast gëlltijeje, nëse personi është i vetëdijshëm, shpëlani gojën me ujë, jepini një gotë me dy gota ujë për të pirë, kontaktoni një mjek ose një qendër mjekësore. Mos nxisni të vjella!! Terapija: aplikoni trajtim simptomatik. Antidot: nuk ka antidot specifik.

Pajisje mbrojtëse personale:

Për personat që përgatisin produktin: doreza mbrojtëse, rroba mbrojtëse, syze/maskë mbrojtëse

Operatorët: doreza mbrojtëse, rroba mbrojtëse, këpucë mbrojtëse

Punëtorët e fermës: doreza mbrojtëse.

Përdorimi, produkti duhet të përdoret vetëm një herë në të njëjtën zonë gjatë një periudhe vegjetacioni.

Ky produkt përdoret në domate, patate, panxhar, bimë leguminoze, luledielli, kolzë, etj. Kontrollon barërat e këqija gjthengushta graminore:

Grami (*Agropyrum repens*, *Cynodon dactylon*); Meli (*Digitaria sanguinalis*); Muhari (*Echinochloa crus-galli*), Kallami (*Phragmites australis*) Kostreva (*Setaria verticillate*); Kostreva thekë verdhë (*Setaria pumila*); Kostreva thekë jeshile (*Setaria viridis*) Talla (*Sorghum halepense*), etj.

Në Domate (nga stadi kur bima ka 4 gjethe të shpalosura deri në periudhën para pjekurisë së plotë);

Në Luledielli (kur bimët janë në stadin e 4-6 gjetheve);

Në Sojë (kur bimët janë në 5-15 cm gjatësi)

Në Panxhar, panxhar sheqer (kur bimët janë në stadin e 4-10 gjetheve të shplosura): për kontrollin e barërave të këqija monokotiledone me dozë 0.7-1lit/Ha, në 200-300litra ujë. Për kontrollin e tallës 0.8-1.2lit/Ha në 200-300litra ujë. Për kontrollin e *Elymus repens*, 2,0-2,5 lit/Ha, në 200-300litra ujë.

Në Patate (trajtimi bëhet kur patatja ka arritur në 5-15cm gjatësi.) për kontrollin e barërave të këqija monokotiledone me dozë 0.7-1lit/Ha, në 200-300litra ujë. Për kontrollin e tallës 0.8-1.2lit/Ha në 200-300litra ujë. Për kontrollin e *Elymus repens*, 2,0 lit/Ha, në 200-300litra ujë.

Në Kolzë (kur bimët janë në stadin e 1-6 gjetheve të shplosura): për kontrollin e barërave të këqija monokotiledone me dozë 0.7-1lit/Ha, në 200-300litra ujë. Për kontrollin e tallës 0.8-1.2lit/Ha në 200-300litra ujë. Për kontrollin e Telishit, 0.4-0.6 lit/Ha, në 200-300litra ujë. Për kontrollin e *Elymus repens*, jo me vonë se kur *Elymus repens*, është në stadin e lulëzimit . 2,0-2,5 lit/Ha, në 200-300litra ujë.

Produkti duhet të përdoret me kujdes pasi mund të jetë i dëmshëm për çdo bimë monokotiledone!

Fitotoksiciteti: Nuk është fitotoksik kur përdoret me dozat dhe në kulturat e rekomanduara.

Vërejtje për përdorimin: Për të shmangur fenomenin e rezistencës ju lutem trajtoni sipas rekomandimeve. Mos aplikoni në kushte të këqija moti, në shi, me erë, ose në orët me temperatura të larta. Mos aplikoni me paisje spërkatëse të cilat nuk funksionojnë mirë ose janë të dëmtuara. Produkti duhet të përdoret me kujdes pasi mund të jetë i dëmshëm për çdo bimë monokotiledone. Lejohet vetëm një trajtim në sezon.

Ndikimi në ekosistem: Mesatarisht helmues për gjitarët, zogjtë, pak helmues për bletët. H400: Shumë toksik për gjallesat ujore. H411: Toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata. Helmues për peshqit dhe për jovertebrorët e tjerë ujorë. Mos ndotni ujrat dhe basenet me produktin ose ambalazhin e tij. Përdorimi i produktit është i ndaluar brenda dhe jashtë zonave të mbrojtjes së ujit për burimet e ujit dhe furnizimin publik me ujë, dhe mund të përdoret brenda zonave të mbrojtjes së ujit me kusht një leje të veçantë. Për të mbrojtur bimët e jo target, spërkatni produktin me kujdes!

Karenca: Luledielli, kolzë, leguminoze, 90ditë, panxhar 60ditë, patate 45ditë, domate 21 ditë.

Ruajtja dhe magazinimi: Ruajeni produktin në ambalazhin origjinal në vende freskëta, të ajrosura mirë larg rrezatimit diellor dhe lagështirës, ruajeni në vende. Mbajeni produktin larg ushqimeve për njeriun, kafshët, dhe ujit të pijshëm. Mbajeni larg fëmijëve.

Nr dhe data e regjistrimit: Nr. 58, datë 19.08.2026.

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 5 lit.

Bar kodi përkatës ;

Data e prodhimit: ... *Printuar nga makineria në ambalazh..;*

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 2 vite;

Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenja të tjera identifikuese: *Printuar nga makineria në ambalazh.;*

Tipi i ambalazhit bazë: shishe plastike COEX ose HDPE.

Emri dhe adresa e Aplikantit: Galenika-Fitofarmacija d.o.o. **Adresa:** Trzaska cesta 515 I SI-1351 Brezovica pri Ljubljana Slloveni.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-së: Galenika-Fitofarmacija a.d. **Adresa:** Batajnicksi drum bb Beograd Serbi.

Distributori për Shqipërinë: Agrohëlp-SA. sh.p.k, autostrada Tiranë –Durrës km22, Xhafzotaj, Durrës Shqipëri.